



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues</i>	<i>Data e autorizimit të ekspertit: 06.06.2022</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit: 09.06.2022</i>	<i>Nr. i lëndës: 181/22</i>
---	--	---	-----------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **02.06.2022**, OE: **“Agribau” Sh.p.k. – Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr.: **181/22**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës)**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me paisje bujqësore për bujqësit në komunën e Skenderajt. Furnizim me mjete bujqësore për lavërtari dhe pemëtari (freza, stërpikëse, shpërndarëse plehu, atomizer, motokultivator dhe kosa e motokultivatorit), furnizim me mjete për blegtori (Llaktofriza dhe mjelset për bagëti)”** me nr. të prokurimit: **643-22-2570-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **K.K. Skenderaj**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **97.000,00 €**

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: “Agribau” Sh.p.k. – Prishtinë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 - Qëllimi

Neni 7 – Barazia në trajtim/Jo-Diskriminim

Neni 28 – Specifikimet Teknike

Neni 108/A – Zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Me date **23.05.2022** Agribau SHPK kemi bere kërkesë për rishqyrtim te vendimit te AK-se date **17.05.2022** për aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me paisje bujqësore për bujqësit në komunën e Skenderajt. Furnizim me mjete bujqësore për lavërtari dhe pemëtari (freza, stërpikëse, shpërndarëse plehu, atomizer, motokultivator dhe kosa e motokultivatorit), furnizim me mjete për blegtori (Llaktofriza dhe mjelset për bagëti)”**, Nr. prok. **643-22-2570-1-2-1**, ku është shpërblyer me kontrate OE Komtel Project Engineering SH.P.K., ndërsa njëkohësisht na ka njoftuar se ne kemi qene te pasuksesshem pasi qe tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët.

- Me date **26.05.2022** AK ka marre Vendim për refuzimin e ankese tone duke mos dhënë asnjë arsytim lidhur me vendimin e marrur dhe duke mos arsyetuar REFUZIMIN ne asnjëherë nga pretendimet tona.

AK me rastin e përgjigjes ne kërkesën tone për Rishqyrtim ka bere shkelje te ligjit te LPP-se pikërisht NENI 108/A paragrafi 9 dhe 12 te këtij ligji ku thuhet:

9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

- AK nuk ka bere vlerësim dhe ekzaminimin e duhur pasi qe OE e shpërblyer me kontrate ne ofertën e saj sipas katalogut ka ofruar Laktofriz 300 ltr. Nga prodhuesi “SETUAY sut ve su sogutma tanklari” ndërsa autorizimi për laktofriz është i lëshuar nga kompania “ESKISEHIR lazer Mak. Muh. SAN.TIC.LTD.STI”, po ashtu ne autorizimin e prezantuar te kompanisë “ESKISEHIR lazer” e cila ka lëshuar autorizimin eshte dhene e-mail-i i kompanisë tjetër “SATUAY” ku ne web-faqen zyrtare te kompanisë “ESKISEHIR lazer” nuk ekziston ndonjë e-mail i kompanisë “SATUAY” që do të thotë se këto janë dy kompani te ndryshme. Kompania ESKISEHIR lazer Mak. Sipas te dhënave ne web-faqen zyrtare nuk është prodhues i Laktofrizave por vetëm bënë saldimin e makinerive te ndryshme. Ndërsa kompania “SETUAY” sut ve su sogutma tanklari” është prodhues i laktofrizave dhe duke u bazuar ne këto informata OE i shpërblyer me kontrate do duhej te kishte Autorizimin nga kompania prodhuese “SETUAY sut ve su sogutma tanklari”

Prandaj OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.** nuk posedon autorizim te vlefshëm nga prodhuesi apo dileri ashtu siç kërkohet ne Dosje te Tenderit.

- OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.**, ka ofruar katalog për Artikullin “**Freza për traktor**” dhe sipas katalogut prodhuesi është YANTAI LANSU dhe ne katalogun qe ka ne webfaqen e kësaj kompanie nuk posedon këtë lloj te frezës me këto specifika.
- OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.**, ka ofruar katalogun për Artikullin “**Kose për motokultivator**” nga prodhuesi Tarall dhe ne katalogun e ofruar është paraqitur një lloj tjetër i kosës e cila është për modelin e motorkoses model **19S Tarall**. Në webfaqen zyrtare te kësaj kompanie nuk posedon kose për motokultivator te llojit siç është ofruar nga OE i shpërblyer me kontrate.

Prandaj AK gjate ekzaminimit dhe Vlerësimit të këtij tenderi duhej marr parasysh mungesën e autorizimit nga prodhuesi dhe për mungesën e këtij dokumenti sipas ligjit mbi prokurimin publik as nuk mund te kërkohet sqarime apo plotësim i dokumentacionit dhe OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.**, do te duhej eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Po ashtu për artikullin **Freza për Traktor** dhe **Kose për motokultivator** AK do te duhej kërkuar sqarime shtese nga OE dhe verifikim për pajisjet e lartcekura.

Pas gjithë këtyre fakteve te ofruara shpresojmë dhe besojmë se Organi Shqyrtues i Prokurimit do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tone dhe do ta aprovoj si te bazuar këtë ankesë duke marr:

Vendim

APROVOHET, si e bazuar ankese e OE “Agribau” Sh.P.K., kundër Vendimit te AK-se date 26.05.2022 aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me paisje bujqësore për bujqësit në komunën e Skenderajt. Furnizim me mjete bujqësore për lavërtari dhe pemëtari (freza, stërpikëse, shpërndarëse plehu, atomizer, motokultivator dhe kosa e motokultivatorit), furnizim me mjete për blegtori (Llaktofriza dhe mjelse për bagëti)**”, Nr. Prok.: 643-22-2570-1-2-1.

ANULOHET njoftimi mbi Vendimin e AK-se datës 26.05.2022 dhe lënda te kthehet ne **Ri-vleresim**, ku do te merret një vendim ne përputhje me Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), nuk janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues, pasi qe AK ne ankesën pran OSHP ka ndryshuar dispozitat e shkelura, duke shtuar **neni 28 të LPP-se**, si dhe **ka larguar nenin 59 dhe 60 te LPP-së**.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë të njëjta me atë të dorëzuar në kërkesa për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kërkesat:

Nje deklarate me shkrim mbi permbushjen e Specifikimeve Teknike te Detyrueshme ne Aneksin 1.

Operatori Ekonomik duhet te kete certifikaten ISO 9001 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) valide.

Operatori Ekonomik duhet te kete katalogun me foto per secilen paisje.

Autorizimi nga prodhuesi apo dileri.

Evidencat:

Deklarata duhet te jet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE.

Deshmia Kopja e certifikates ISO 9001 2015 Sistemi i Menaxhimit te Cilesise.

Deshmia Operatori Ekonomik duhet te ofroje deshmi katalogun me foto per secilen paisje.

Deshmia Autorizimi nga prodhuesi apo dileri per shitjen e paisjeve te mekanizmit bujqesore. (Autorizimi kopje).

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim: (Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Operatori ekonomik,

Komtel Project Engineering Sh.P.K., ka ofruar çmimin me te ulet krahas operatoreve tjerë ekonomik dhe po ashtu ka te gjitha dokumentacionin qe kërkohet me njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA E EKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden ne platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Agribau” Sh.p.k. – Prishtinë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK me rastin e përgjigjes ne kërkesën tone për Rishqyrtim ka bere shkelje te ligjit te LPP-se pikërisht NENI 108/A paragrafi 9 dhe 12 te këtij ligji ku thuhet: *“9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim. 12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”.*

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka pranuar kërkesë për rishqyrtim me date 23.05.2022, ndërsa ZPP ka pezulluar aktivitetin e prokurimit ne platformën elektronike, duke vepruar ne pajtim me **nenin 108/A par. 2 te LPP-së**, ku thotë: *“Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”*, pastaj ZPP me date 26.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke mos vepruar ne pajtim te plote me **nenin 108/A par. 9 te LPP-se**, ku thotë: *“Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.”* si dhe **nenin 108/A par. 12 te LPP-se**, ku thotë: *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”*, që do të thotë se AK – ZPP ka qene i obliguar te veproj ne pajtim te plote sipas nenev dhe sqarime si me larte, pasi qe vendimi i nxjerr nga ZPP i datës 26.05.2022 i mungon pjesa kryesore – dispozitiv (arsyetime i refuzimit te kërkesë për rishqyrtim), si dhe nuk është ngritur ne platformën e-prokurim ashtu siç kërkon njoftimi **Nr.15/2020 i nxjerr nga KRPP me date 28.01.2020**, ku thotë, përgjigjet t’i ngarkoni tek funksion “dosja e tenderit” si dokument shtesë. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK nuk ka bere vlerësim dhe ekzaminimin e duhur pasi qe OE e shpërblyer me kontrate ne ofertën e saj sipas katalogut ka ofruar Laktofriz 300 ltr. Nga prodhuesi “SETUAY sut ve su sogutma tanklari” ndërsa autorizimi për laktofriz është i lëshuar nga kompania “ESKISEHIR lazer Mak. Muh. SAN.TIC.LTD.STI”, po ashtu ne autorizimin e prezantuar te kompanisë “ESKISEHIR lazer” e cila ka lëshuar autorizimin eshte dhene e-mail-i i kompanisë tjetër “SATUAY” ku ne web-faqen zyrtare te kompanisë “ESKISEHIR lazer” nuk ekziston ndonjë e-mail i kompanisë “SATUAY” që do të thotë se këto janë dy kompani te ndryshme. Kompania ESKISEHIR lazer Mak. Sipas te dhënave ne web-faqen zyrtare nuk është prodhues i Laktofrizave por vetëm bënë saldimin e makinerive te ndryshme. Ndërsa kompania “SETUAY” sut ve su sogutma tanklari” është prodhues i laktofrizave dhe duke u bazuar ne këto informata OE i shpërblyer me kontrate do duhej te kishte Autorizimin nga kompania prodhuese “SETUAY sut ve su sogutma tanklari”

Prandaj OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.** nuk posedon autorizim te vlefshëm nga prodhuesi apo dileri ashtu siç kërkohej ne Dosje te Tenderit.

- OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.**, ka ofruar katalog për Artikullin **“Freza për traktor”** dhe sipas katalogut prodhuesi është YANTAI LANSU dhe ne katalogun qe ka ne webfaqen e kësaj kompanie nuk posedon këtë lloj te frezës me këto specifika.

- OE **Komtel Project Engineering SH.P.K.**, ka ofruar katalogun për Artikullin **“Kose për motokultivator”** nga prodhuesi Tarall dhe ne katalogun e ofruar është paraqitur një lloj tjetër i kosës e cila është për modelin e motorkoses model **19S Tarall**. Në webfaqen zyrtare te kësaj kompanie nuk posedon kose për motokultivator te llojit siç është ofruar nga OE i shpërblyer me kontrate.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, sqarimin e kërkuar nga AK përmes e-mali-i lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nga OE ankues, ka dhënë një përshkrim të dhënave apo gjendjes, por nuk ka ofruar asnjë agrumet, provë apo ndonjë dëshmi bindëse se pretendimet e tij janë të bazuara ne informacion të saktë, pasi qe OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar autorizimet për secilën pajisje, katalogun dhe deklaratën mbi specifikimet teknik, andaj konsideroj se AK – komisioni i vlerësimit, ZPP ka vepruar sipas kërkesave të dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate apo Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të FDT-se, duke vepruar ne pajtim me **nenin 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*”, si dhe **nenin 60 par. 1 pika 1.1 të LPP-së**, ku thatë: “*tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët*”;

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **ka respektuar nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP**, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni të plote me dispozitat ligjore të LPP-se, ne këtë aktivitet të prokurimit, ne mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje të tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **nuk janë të qëndrueshëm**.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE, **të aprovohet si pjesërisht e bazuar**, dhe rekomandon të mbetet ne fuqi vendimi B58-njoftimit mbi vendimin AK – (vendimit për dhënie të kontratës).

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues* – *K.K. Skenderaj*
- *Panelit Shqyrtues* – *OSHP*
- *OE ankues* – *“Agribau” Sh.p.k. – Prishtinë*